



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.01.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rrustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rrustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtar
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar

28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Syla, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Anila Reçica, DKRS
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Bekim Shabani, DP
7. Safete Amerllahu, DGJK
8. Shkelzen Hajdini, DSH
9. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
10. Imer Rrustemi, DSHPMSH
11. Flamur Sylejamni, DI
12. Elmaze Behluli, DA
13. Sead Aliu, DI
14. Rexhep Rexhepi, DBP
15. Rasim Hasani, DA
16. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile
17. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj të jeni mirë dhe të keni shëndet.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, por para se të fillojmë me rendin e ditës kemi dy zëvendësime të anëtarëve të Kuvendit, nga subjekti politik LDK. Ku Gentianë Hoxhaj e zëvendëson Safete Amerrllahun dhe Venhar Agushi e zëvendëson Hyra Bytyçin, për shkak se të njëjtat tani janë pjesë e ekzekutivit

Pastaj tha Rrendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2021, duke u bazuar në raportet FB të datës 17.01.2022.
3. Informatë mbi Pandeminë nga Drejtorati i DSHPS-së
4. Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB.
5. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
6. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.
7. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
8. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Arsim.
9. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtareve te kuvendit.

Arsim Jashari,tha se kam dy çështje për ti ngritur, e para ka të bëjë me drejtoratin e Arsimit, ku para disa muajve ne shkollën Adem Gllavica në Lipjan është gjete një armë zjarrit të një nxënësi të kësaj shkolle. Po ashtu edhe në shkollën Ismajl Luma, çdo ditë gjenden armë te ftohta të nxënësit. Çka keni ndërmarr ju në këtë aspekt dhe cila është zgjidhje e këtij fenomeni? Është mirë qe kjo çështje te diskutohet edhe në KKSB te cilin do ta formojmë sot, dhe është mirë të vendosen një skaner detektor ne hyrje te shkollës. Çështja e dytë ka të bëjë me mos interesimin e pjesëmarrjes se qytetarëve në dëgjimet publike ,cila është arsyeja mos informimi me kohe apo mungesa e strategjisë nxitëse. Dhe çështja e tretë, do te ishte krijimi i politikave efektive,e ku komuna do te duhej ti hartoj këto politika si politika për punë vullnetare, për funksionalizimin e këshillave te fshatrave, për angazhimin

personave me nevoja te veçanta e te tjera, e disa janë në strategjinë e komunës por nuk po zbatohen.

Ganimete Qeriqi, kam disa çështje për ti ngritur e para ka te bëjë me materialin e kuvendit i cili po na vjen ne mënyre fizike nuk po duket e përshtatshme do te duhej te gjinden një zgjidhje te pajisemi me llaptop , te na ndalen nga paga ose mëditja. Kërkesa e dytë është nga kolegët e emergjencës ku punoj, qe te na bëhet një objekt i ri pasi qe ai objekt nuk i plotëson kushtet qe te punohet aty. Po ashtu funksionalizohen ekipet mobile pasi po janë shumë te nevojshme. Kërkesa tjetër ka të bëjë me urgjencën qe aty te jetë në ndërrimin e natës një teknike-motër pasi qe është nevojshme sepse aty nuk ka asnjë punëtor nga gjinia femërore.. Punëtorët e emergjencës nuk kanë kurçfar stimuli për punën qe po e bëjnë..

Daut Azemi, ju kisha lut me qenë sa me te shkurte gjatë diskutimit ta respektoni rregulloren e punës së kuvendit te fokusoheni ne pyetje dhe jo te bëni diskutime.

Nexhmedin Lekiqi, unë pata me bo një analizë pak me të gjatë por pasi është koha vetëm për pyetje po mundohem te jem ma i shkurtë. Pajtona me parafolësen qe objekti i urgjencës nuk i plotëson nevojat dhe kërkoj nga ekzekutivi qe kjo te merret parasysh. Po ashtu është mirë qe në QMF- si në Gadime dhe Magure, te punohet me shumë ne ato ambulanca dhe aty te ndalen pacientët, por te ketë edhe një autoambulancë edhe ne këto vende. Ka nevojë ne vendin ton qe ende te ketë ndryshime e te punohet për te mirën e vendit tonë.

Rinor Murati, tha kam disa çështje për ti ngritur, e para, sa i përket konkursit për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit. Komisioni vlerësues ka publikuar listën preliminare me 80 përfitues dhe tani ka përfunduar edhe afati për ankesa mirëpo duke pasur parasysh situatën pandemie që kemi kaluar dhe periudhën që po gjendemi ku kemi rritje të çmimeve në produktet elementare, tani edhe çmimi i energjisë elektrike, do ishte vendim i drejtë që pas shqyrtimit të ankesave, numri nga 80 përfitues të rritet në 120, sikurse në vitin 2020 dhe kjo do ishte një ndihmë mjaft e madhe për familjet. Gjithashtu, konsideroj që Rregullores për ndarjen e bursave komunale i duhen ndryshime andaj kërkoja nga Drejtoria e Arsimit që të shqyrtoj kërkesën për fillim të procedurave për ndryshimin e saj, përkatësisht harmonizimin apo ristrukturimin e kriterëve. Dhe çështja tjetër, adresova pyetjen se kur do përfundojnë punimet në rrugën Lipjan-Rubovc, punimet në hekurudhë në atë pjesë dhe në trotuarin nga fshati Kojskë në fshatin Rubovc, pasi që punimet janë ndërprerë shkak i motit.

Egzona Bytyqi,tha kam me adresuar një çështje qe ka te bëjë me grevën e punëtorëve te minierës se Goleshit te cilët janë ne grevë nga data 23 janar, për shkak te një vendimi te AKP-s për shkëputjen e kontratës e ku sipas grevisteve kjo po cilësohet si jo ligjore. Unë se bashku me shefin e grupi te PDK-s, do ti vizitojmë pas kësaj mbledhje dhe ju thëras te shkojmë se bashku ti vizitojmë edhe ekzekutivi. Çështja e dytë ka të bëjë me vendosjen e një tende ne oborrin e QKMF-s, për testim për covid ne mënyrë qe te jetë ma e lehtë për qytetarët dhe te ketë sa me pak kontakte me personat tjerë.

Majlinda Sylejmani,unë kam të ngris një shqetësim lidhur me supermarketet në komunën e Lipjanit ku shumë prej tyre mbajnë produkte me afat të skaduar dhe shpesh herë ju ndryshojnë tiketat për të ju vazhduar afatet. Kërkoj nga drejtori i Inspektionit të këtë kontrollë më të shpeshta nëpër markete.

Bashkim Budakova,tha se kam një çështje për ta ngritur të banorëve të fshatit Rubovc, për dhenjen në shfrytëzim të një prone për varrezat e këtij fshati,pronë komunale,e cila kërkesë është miratuar në këtë kuvend, por tani është në kontest gjyqësor. Kërkoj nga ana juaj të bëni një zgjidhje për banorët e këtij fshati pasi qe kjo është kërkesë e kamotshme e banorëve.

Lumturije Bytyqi-Hasani,tha se kam ta ngris çështjen rreth qenve endacak, e di qe është një përzije e kompetencave ne mes te nivelit lokal dhe atij qendror por komuna është dashtë me bashkëpunuar me nivelin qendror dhe ne bashkëpunim me ta me trajtua këtë çështje pasi po janë rrezik për qytetarët e sidomos ne këtë kohe te dimrit . E dyta ka te bëjë me nxensit e shkollës Adem Gllavica të cilët po ankohen se nuk po mbahen lendet e informatikës ne kabinet, për shkak se aty nuk është bër lidhje e llaptopëve dhe kompjuterëve dhe pse aty janë ato pajisje. Po ashtu ne këtë shkolle janë investuar disa llaptop dhe projektor neper klasë por ende nuk janë instaluar, pse po ndodhë kjo. Disa punëtor të arsimit po e kërkojnë një vërtetim qe e deshmon përvojë e punës dhe aty nuk po ju shënohet ditët e njëjta dhe me këtë drejtoret e shkollës po bëjnë shkelje me qellim apo pa qellim duke ja humbur ditët e punës, dhe duhet te kenë kujdes mos të bëhet ky gabim.

Ardit Cani,tha se kam për ti ngritur disa çështje, rreth fshatit Bainsë, e para ka të bëjë me pastrimin e lumit "Drenica" pasi gjatë kohës së dimrit ky lum po shkakton probleme po ka vërshime dhe është rrezik për qytetarët. E dyta ka të bëjë me asfaltimin e rrugicave në fshatrat Bainsë dhe Risionvc , ku kemi dy raste invalidore dhe gjatë stinës së dimrit atyre po ju pamundësohet dalja

Shahadije Bikliqi-Dragaqina, tha se dua ta ngrisë disa çështje e para ka të bëjë me një ankesë të banorëve të rrugës Zylfije Gashi e cila kërkesë është drejtuar te ju qe 8 muaj dhe e nënshkruar nga mbi 60 qytetarë për vendosjen e policëve të shtirë pasi qe aty vozitet shumë shpejtë dhe po rrezikohen qytetarët, ju kish lut qe kjo te merret parasysh. Po ashtu ne atë rrugë është punuar diçka por aty punët janë lënë shumë keq dhe nuk e di a ka dal inspekcioni ndonjë herë me vizatu atë vend. Çështja e dytë qe do të reagojmë si grup i Lëvizjes Vetëvendosje është vazhdimi i punësimeve familjare dhe partiake në sektorin e arsimit edhe në këtë mandat. Kryetar me këto punësime duhet dhënë llogari para qytetarëve të Lipjanit. Ju po bëni edhe shkelje të drejtave të kandidatëve të tjerë që e meritojnë me qenë nëpër këto pozita por pasi nuk janë pjesë e LDK -së dhe grupit tënd të ngushtë injorohen dhe anashkalohen. Dhe gjithashtu me këtë po bëni edhe shkelje ligjore pasi ligji për shërbimin civil e thotë shumë qartë, respektimin e "meritokracisë". Për këtë duhet të na jepni një shpjegim pasi ju me punësime të tilla konsiderojmë se po e dëmtoni edhe cilësinë në arsim. Këtë mandat duket se do të bëni gabime në mënyrë të hapur, pa u ruajtur fare as nga qytetarët, as nga partitë politike këtu në kuvend e as edhe nga bashkëpartiakët tuaj.

Besaian Sylja, tha se kam me ngrit një çështje të banorëve të rrugës Epopeja e UÇK-së në lagjen e Akllapit ku po ankohen se kjo rrugë ka kohë qe nuk është asfaltuar ,po ashtu nuk ka as ndriçim publik, pse nuk jeni marr me këtë çështje.

Alban Salih, kam për ti ngritur dy çështje qe janë të ndërlydhura njëra ka të bëjë me kualitetin e punimeve qe po kontraktohen nga komuna, para disa dite kalova te shtegu i ecjes dhe aty është një investim i qëlluar por punët të cilat janë kryer aty janë bërë shumë keq dhe aty është prishur menjëherë, nuk e di a është ndëshkuar dikush për atë punë, apo a është marr dikush me atë çështje. Tjetra qysh po vendosen prioritete kur po investohet me shumë të mëdha siç është tregu i gjelbër aty është gjendja e mjerueshme, po ashtu njëjtë është dhe gjendja me stadiumin në fshatin Magure.

Lulzim Rrustemi, kam një kërkesë për DSHP rreth lumit Janjevka ku i kisha lut drejtoratin të kenë kujdes rreth hartimit të projektit detal pasi qe aty është një vi e lartë përçuesve .Prandaj duhem me marr parasysh këtë se kur po është koha e dimrit po ka vërshime.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha, një sugjerim i mirë i Lulit rreth lumit Janjevka ,dhe aty është duke u bër një investim i mirë .Tregu gjelbër kemi thanë produktet ushqimore do të mbesin aty ku kanë qenë ndërsa produktet jo ushqimore

do të barten te tregu i ri. Tregu i ri është demoluar për shkak të erës e jo për diçka tjetër, kemi pas edhe kulma te shtëpive te cilat janë demoluar dhe për këtë kemi edhe procesverbale. Punimet të cilat po bëhen lënë për të dëshiruar, ne kërkojmë nga kompanitë certifikatë dhe ato i kanë pruar. Shtegu i ecjes nuk është dëmtuar vetëm është plasaritë, dhe ne atë nuk e kemi paguar dhe nuk do ta paguajmë po u përfunduar si duhet. Te rruga Epopeja e UÇK-së, apo edhe rrugë tjera në lagjen e Akllapit dhe ne Lipjan, te cilat janë rrugë private ne nuk investojmë pasi që nuk kemi mundësi ti bëjmë gjithë ato shpronësime. Kemi kërkuar nga ata banorë që ta na epin pëlqimin dhe ata nuk na kanë dhënë pëlqimin. Ne do të asfaltojmë vetëm ku ka pëlqime. Sa i përket punësimeve kush do që i plotëson kriteret do të punësohet, dhe dikush mundet me kanë djali, gurja apo motra e dikujt se janë mbi 16 mijë votues. Rruga Zylfije Gashi në Lipjan është e buxhetuar dhe do të ketë asfaltim te asaj rrugë. Hapja e lumit Drenica në baincë do të bëhet, ndërsa rrugicat tani nuk i kemi. Qenet endacak problem që e kemi diskutuar disa herë nga kryetarët e komunave por kjo është e nivelit qendror. Varrezat ne Rubofc derisa jeni ne proces gjyqësor ne nuk mujm te ndërhyjmë. Por ne duhet me gjete një zgjidhje për banorët e fshatit Rubovc për varreza. Për produktet me afat të skaduar kërkoj nga Inspektoriati et merret me shumë me këtë çështje. Qeshtja e bursave e drejte 80% e tyre e meritojnë bursën por problem te gjithëve te ju ndajmë bursa, edhe rregullorja duhet te ndryshohet. Rruga në Rubofc është dëmtuar nga niveli qendror hekurdhua, por kam kërkuar nga qytetaret e asaj pjese ta ndihmojnë, ne kemi vendosur edhe një shenje për ndalimin e qarkullimit me peshe te rënde. Unë pre që për shëndetësi te ndryshohet përformanca pasi që kemi edhe këtu disa netra te asamblesë nga mjekësia, dhe ne e kemi paraparë edhe investime ne urgjence dhe një autoambulance te re. Kemi nevojë për angazhime e politika te reje.

Arsim Jashari, tha kam një shqetësim për armët te cilat po gjinden nëpër shkolla sidomos në shkollën Adem Gllavica dhe Ismajl Luma po ashtu çdo ditë në këto shkolla po ka rrahje është mirë te vendoset një detektor.

Alban Salihi, tha ne si subjekt dislokimin e tregut nuk e kemi pas premtim,dhe ne as se kemi përkrah këtë si subjekt. Shtigjet e ecjes janë në gjendje jo të mirë dhe dikush duhet te mbaj përgjegjësi.

Ganimete Qeriqi, a do te ketë në emergjencë në ndërrimin e natës një femër. Dhe drejtoreshat tani te zgjedhura kërkoj që te jenë më bashkëpunuese.

Imri Ahmeti kryetari i komunës, tha se do te shohim nga drejtorati i shëndetësisë a ka mundësi të respektohet barazia gjinore në çdo sektor.

Huliganizmi edhe në shkollën tonë është prezent, por ne duhet me gjete mekanizma për frenimin e fenomeneve të tilla. Është një fenomen e dukuri qe duhet ti qasemi të gjithë së bashku. Shtigjet ne nuk i kemi paguar pjesën qe janë kryer sipas projektit, ndoshta kjo do te shkoj edhe në gjykatë si lëndë. Dhe ne jemi këtu për të punuar.

Daut Azemi, e falënderoj kryetarin e komunës z.Imri Ahmeti për gatishmërinë qe te ju përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të anëtarëve të kuvendit.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 2 të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Besiana Syla,kam vërejtje pasi qe nuk janë përfshirë në ekstrat te gjitha ato qe i kam thënë dhe kërkoj nga ana juaj te jeni sa ma korrekt.

Lulzim Rrustemi,çështja e procesit është e rëndësishme dhe duhet te jeni ma të kujdesshëm, unë i kam përmend te statuti qe mungojnë disa fshatra dhe nuk janë shënuar te gjitha. E di qe nuk është punë e lehtë por duhet me shumë kujdes.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se do ti kemi parasysh këto, mirëpo ekstraktet e kuvendit nuk përfshijë të gjithë fjalimin por vetëm pjesën kryesore. Kur te dalim në komunën e re do te kemi një transmetim te ri dhe do të shënohen vetëm emrat e diskutuesve

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 2 të me vërejtjet e cekura me lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për Ekstratin

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 2 të e të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti

II.

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2021, duke u bazuar në raportet FB të datës 17.01.2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se sa i përket raportit të shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2021 komuna e Lipjanit është ndër komunat ma të mira duke shpenzuar buxhetin më së miri dhe duke treguar potencial dhe për donacione të tjera. Ne si grup i LDK-së e falënderojmë drejtoratin për menaxhimin e mirë të financave publike të komunës.

Besiana Sylja, tha se Komuna e Lipjanit, në bazë të raportit të shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën Janar-Dhjetor, pohon se ka shpenzuar buxhetin final në mbi 90%, e që është një përqindje e kënaqshme, por për të përfituar ky raport apo pasqyrë financiare besueshmëri, duhet t'i nënshtrohet auditimit. Pra, besueshmeria arrihet vetëm atëherë kur kryhet auditimi nga auditori i jashtëm dhe ajo është Zyra Kombëtare e Auditimit. Siç po shihet nga raporti, në bazë të fondeve burimore, theks të veçantë i kisha kushtuar grantit qeveritar, ku shihet se grandit është shpenzuar në një përqindje prej mbi 90 %, mirëpo por një shumë e mjeteve ka shkuar suficit Suficiti i grantit qeveritar siç po shihet është në mallra dhe shërbime. Pse ka ardhë deri tek ky suficit? Po ashtu edhe tek fondi burimor i donacioneve kemi një mbetje prej mbi 11 mijë euro. A do të ketë Komuna marrëveshje të re me këta donatorë për bartjen e kësaj shume në vitin 2022? Ne bazë të raportit të hyrave vetanake, siç po shihet, Komuna ka arritur ta plotësojë cakun që ka caktuar Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe të njëjtin e ka tejkalluar deri me datën kur është përpiluar raporti. Në bazë të raportit, siç po shihet të hyrat nga tatimi në pronë marrin pjesë me 46,23%. Nëse shikohet në mënyrë analitike, pozicionet në të cilat është planifikuar e hyra, kemi një jo balancim, ku ne disa pozicione kemi edhe mosrealizim të të hyrave vetanake, e ne disa kemi tejkallim të të hyrave. Do të isha përqëndruar më shumë në tatimin në pronë ku është burimi më i sigurt për arkëtimin e të hyrave, ku Komuna ka një tejkallim prej 19.20% prej asaj që ka planifikuar, mirëpo në bazë të Raportit të Auditorit, Komuna në llogari të arkëtueshme (që na kanë borxh) ka afër 4 milion euro. Çka do të ndërmarrë Komuna që llogaritë e arkëtueshme të zvogëlohen?

Lulzim Rrustemi, sipas këtij raporti buxheti është shpenzuar në një formë mjaftë të kënaqshme. Ndërsa sipas kategorive ekonomike të subvencionet ka mbetur një shumë e mirë e mjeteve pa u shpenzuar. Buxheti nga huamarrja është shpenzuar bukur mirë. Nga granti qeveritar kanë mbetur të pa shpenzuara, e të cilat shkojnë suficit, dmth mjete të humbura. Të buxheti i shpenzuar, nga donatorët kemi një shumë të mirë të mjeteve. Buxheti sipas kategorive ekonomike të drejtorati për shërbime publike një shpenzim i mirë por le vend për të dëshiruar. Po ashtu të drejtorati për bujqësi ka mbetur një shumë e mjeteve e pa shpenzuar të subvencionet e të cilat pritet të shpenzohen në vitin 2022. Po ashtu të Shëndetësia ka një shumë të mjeteve të humbura si dhe edhe të disa drejtorate tjera kemi humbje të mjeteve, siç është arsimit fillor dhe ai i mesëm dhe drejtorate tjera. Të tatimit në pronë kemi një shumë të mirë të mjeteve ku është bërë një punë mirë nga ana juaj, por edhe një falënderim shkon për qytetarë. Të lejet e ndërtimit nuk kemi shumë të mirë as të taksat mjedisore. Qeraja nga objektet publike nuk është paguar dhe nuk janë mbledhë me kohë mjetet. Po ashtu të shfrytëzimi i pronës publike kemi pak mjete të mbledhura. Të mirëmbajta e veturave kemi dyfishim të mjeteve. Po ashtu kush janë përfituesit individual që janë. Dhe të shërbimet kontraktuale duhet të cekën në buxhet se sa janë shpenzuar. Po ashtu projektet të cilat po ndërtohen nuk po shikohen apo bëhen mirë, po bëhen shkel e shko.

Latif Ramadani, komuna e Lipjanit është ma e mira në nivel vendi për shpenzimin e buxhetit. Na si komune çdo herë jemi vlerësuar me opinionin ma të mirë nga auditori. Në këtë raport e kemi një pasqyre reale të asaj që është punuar në terren. Donacionet në bazë të marrëveshjes barten dhe nuk humb asgjë komune e Lipjanit. Në shpenzimet kryesore në bazë të faturave të ardhura. Qiraja inkasohet vetëm prej atyre lokaleve që janë në shfrytëzim.

Lulzim Rrustemi, tha të sheshi Adem Jashari një projekt ai figuron i aprovuar, por nuk figuron si projekt i realizuar. Të qiraja e objekteve publike a mundën me u planifikuar pa kontrata.

Latif Ramadani, tha se sa i përket sheshit Adem Jashari, është hiç nga kuvendi vitin e kaluar. Për realizim të qerases i realizojmë vetëm ato që janë me kontratë.

Pastaj kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, tha kërkoj 5 minuta pauzë nga ora 12:00 deri në 12:05

III

Informatë mbi Pandeminë nga Drejtorati i DSHPS-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini drejtor i DSH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se edhe në KPF i kam dhënë disa komente e te cilat do ri përsëris edhe këtu. Pandemia ka qenë sfiduese për të gjithë. Unë kam disa pyetje nga numri total i të infektuarve sa ka qenë numri i atyre qe janë shëruar plotësisht duke përfshirë QKMF-në. Sa ka qenë numri i atyre pacientëve qe është dashtë me i udhëzuar në klinikat specifike si Infektive, Pulmologji apo në ndonjë klinikë tjetër dhe arsyet pse janë udhëzuar. Do të ishte mirë me pas edhe një informatë rreth QPS-s, sidomos për dhunën në familje. Kur e ka mbajte takimin e fundit shtabi emergjent, a ka dhënë ndonjë rekomandim?

Gazmend Qerkini, tha se na si staf shëndetësor jemi përballë çdo ditë me numër të madh të pacientëve të cilët kanë vuajtur nga pasojat të cilat i ka shkaktuar virusi. Parafolësja i tha shumicën dhe pajtona me të, pasi qe këtë virus ende nuk e dimë se cilat pasoja do ti le në të ardhmen personat te cilët janë ataku me virus.

Rinor Murati, tha se kam një pyetje a është aktiv shtabi emergjent për menaxhimin e pandemisë pasi qe tani po përballemi edhe me valën e tretë të virusit.

Ganimete Qeriqi, tha qe kërkoj nga drejtori te kemi bashkëpunim, dhe te merren modelet ma te mire për te mirën e shëndetësisë dhe të qytetarëve.

Nezhmedin Lekqiqi, tha se unë pajtohena me Ganimeten qe të jetë një femër ne emergjence në ndërrimin e natës, pasi qe motrat, nënë tona bëjnë kontrolle aty dhe nuk munden një shërbim te kryejnë kur nuk është një femër aty, pasi qe është e drejtë elementare e pacientit me zgjedh doktorin apo motrën. Po ashtu kërkoj nga drejtori qe te ketë një autoambulancë pasi qe është e drejtë elementare e qytetarit.

Fitim Mëziu, tha se pandemia ka qenë sfiduese për të gjithë, ne stafin shëndetësor kemi qenë në vijën e parë të shërbimeve. Unë kam për ti ngritur disa çështje, e para ka të bëjë me organizimin e punës ne QKMF, pasi disa herë jemi rrezikuar me infektim nga qytetarët edhe na si personel shëndetësor e ajo mund të

ndodhë edhe tani pasi që prioriteti ynë është që të ju shërbejmë sa më mirë qytetarëve dhe është mirë të merremi me masat dhe ta ndalojmë që mos të jenë të njetin vend edhe pacientët me covid dhe me sëmundje tjera. Pacientët e mi të cilët i kontrollojmë të gjithë e kanë gjendjen e mirë, me përjashtim të një rasti me ndezje të mushkërive .

Lumturije Bytyqi-Hasani,tha se do të doja që nga ky kuvend të dalim me disa rekomandime e para qendra e vaksinimit të martenteti nuk është që i plotëson kushtet dhe do të ishte mirë me transferuar edhe nëpër QMF në Shalë, Magure dhe Janjevë dhe Gadime. Rekomandimi i dytë të bëhen testet e dimerit dhe CRP në QKMF.

Lulzim Rrustemi,një informatë rreth pandemisë shumë e mangët, dhe këto janë thënë në informatën e marsit të vitit të kaluar. Në këtë informate është dashtë me shikuar ku o qytetari, a ka infuzione a ka injeksione, apo ofron QKMF-ja shërbime. Sa ju ka ofruar ndihmë qytetarëve komuna gjatë pandemisë, përveç ndihmave financiare në fazën e parë, dhe një vendim që je vetizolim diçka tjetër a ju ka ofruar. Po ashtu dobësi ka qenë vaksinimi ku janë grumbulluar qytetarët të qendra Beter Life ,për vaksinë dhe kanë pritur me orë në ren. Po ashtu të ketë një informatë rreth Obikronit, të ketë një sensibilizim shtesë, dhe ven me të mirë për vaksinonim.

Shkelzen Hajdini,momentin që do të marr të gjitha të dhënat të cilat i kërkuat do të ua dërgoj. Shtabi emergjent është aktiv, tani janë zëvendësuar ish drejtorët me drejtorët e ri, kryetari është udhëheqës i shtabit ,ndërsa nënkryetarin e ka autorizuar kryetari për mbajtjen e takimeve .Deri tani kemi mbi 30 nga stafi shëndetsor të infektuar me covid. Cdo rekomin apo propozim të juajin ne do ta marrim parasysh.Këtë vit do të ketë një autoambulancë plus. Sa I perket vaksinimit për dy dozat e para ka pas interesim ndërsa për dozen e 3 të nuk ka pas interesim, do të shohim edhe nevojat të cilat janë me të medha për qytataret të shtyjme përpara.

Ganimete Qeriqi,unë kërkova që në nderimin e natës të jetë një femër, po ashtu të jetë edhe një ekiye për vizita shtëpiake.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

V

Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Dimanat Bytyqit, nënkryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi vendimin:

Shtesë: Vendimi

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSBB

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Lipjanit , (në vazhdim të tekstit KKSBB), në përbërje si vijon:

1. Imri Ahmeti, Kyetar i Komunës –Kryesues i KKSBB-së
2. Naser Sinani, Komandant i Stacionit Policor,
3. Zaim Baftiu, Bashkësia Islame
4. Dragisha Jerinic, Kisha ortodokse
5. Don Mateje Paliq, Kisha katolike
6. Fahrije Llugiqi, Komuniteti shqiptar
7. Zoran Radiq, Komuniteti serb
8. Alush Bikliqi, Komuniteti turk
9. Perparim Rexhepi, Komuniteti ashkali
10. Maksut Gashi, Komuniteti, rom
11. Goleme Petar Franjo, Komuniteti kroat
12. _____, Kryesuesi i komitetit për komunitete
13. Gjyste Dabaj, Zyra për barazi gjinore
14. Rasim Hasani , Drejtori i Drejtoratit për Arsim
15. Milazim Sadiku, Kryetar i Këshillit të prindërve
16. Kap. Fejzullah Fejzullahu, Përfaqësues nga FSK
17. Fehmi Gajtani, Këshilli Lokal për siguri publike
18. Haqif Rrustemi, Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
19. Imer Rrustemi, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Sektori i emergjencave civile

20. Zoran Stanojvic, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
21. Bekim Krasniqi nga OJQ YAHR , Përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara

Neni 2

Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siç i ka Kryesuesi i KKSB-së.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të KKSB-së është i njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Detyrat, përgjegjësitë , mbledhjet dhe çështjet tjera që lidhen me punën e KKSB-së janë të përcaktuara me dispozitat e Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 5

Për punën e tyre anëtarët e KKSB-së paguhen nga buxheti Komunës. Kompensimi për anëtarët e KKSB-së për pjesëmarrje në takime, bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Poitikë dhe Financa.

Kompensimi për pjesëmarrje në takimet e KKSB-së bëhet vetëm për gjashtë (6)takime të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen elektronike të Komunës.

V

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Gazmend Qerkini, tha se ni grup i LDK-së, për anëtare të Komitetit për Komitete e propozojmë Gnetianë Hoxhaj.

Arsim Jashari,tha se pasi ne e kemi nënkryetarin nga komunitetet do të ishte mire qe roli i gruas të ishte prezentë, dhe do të ishte mirë te jetë një femër në komitet nga komunitetet ,si përfaqësuese e tyre. Ne si grup i PDK-së për anëtar të komitetit e propozojmë Lulzim Rrustemin.

Daut Azemi, tha se unë e kam bërë me shkrim njoftimin dhe kërkesa duhet të jetë e gjinisë femërore, kemi pas konsultim të përbashkët me të gjitha grupet dhe unë nuk do ta pranoj propozim tuja për anëtarë të komitetit për shkak se duhet te jetë nga gjinia femërore dhe duhet ta ndryshoni emrin ose ndryshe unë do ta qes ne votim pa emrin e subjektit tuaj. Neve kështu po na e kërkon ministria, kisha kërkuar mirëkuptim nga ana juaj me ndërruar propozimin.

Alban Salihu, ne si grup i LVV-së e propozojmë Shahadije Bikliq-Dragaqina

Arsim Jashari, qëndrimi jonë si subjekt i PDK-së është ky propozim, dhe nuk mund ta ndryshoj askush qëndrimin tonë.

Daut Azemi, në bazë të udhëzimit administrativ LDK-ja ka mujt me i pas të gjithë anëtarët vet në këtë komitet, mirëpo ne kemi dashtë qe mu përfshi te gjitha subjektet.

Lulzim Rrustemi,udhëzimi është i qartë,mandatin e kaluar kemi pas vetëm një anëtare femër në komitet,te drejtën tonë të PDK-së s'mundet askush me ndryshuar.

Daut Azemi, në këtë udhëzim duhet të respektohet barazia gjinore. Unë nuk e mohoj kontributin tënd qe ke dhanë në Komitet.

Lulzim Qerimi, ne si komitet mandatin e kaluar nuk kemi pas anëtar ne komitet, ja kemi lëshuar komitetit malazez,ndërsa këtë mandat do te jetë anëtari i kuvendit Enver Kryeziu pjese e komitetit.

Arsim Jashari, unë thash qe anëtari nga komuniteti, është mirë me zhvillu rolin e gruas te komitetet.

Daut Azemi, kan mu formu edhe komitete tjera, dhe komisione dhe pres mirëkuptimin tuaj .

Lulzim Rrustemi, udhëzimi thotë qe duhet me qenë 50%, por edhe nëse unë nuk jam ne komitet prapë i ke 5 me 4. dhe se di pse po donë me ndryshuar këtë propozim.

Daut Azemi, spo du unë me ndryshuar po kështu e thotë udhëzimi dhe unë po e zbatoj. Poprozoj qe kjo pikë të shtyhet ne fund, kalojmë në pikën tjetër.

Kalojmë në pikën tjetër.

VI

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Daut Azemi, tha se pari ia uroj detyrën e shefit të grupit të LDK-së Gazmend Qerkinit,

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, ne si grup i LDK-së , për anëtare të KPF-së në vend të Hyra Bytyqi e propozojmë Albiona Tasholli.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa

Me këtë Vendim, zëvendësohet anëtarja e komitetit për politikë financae znj. Hyra Bytyqi e caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 15Nr.020-78081 të datës 24.12.2021 , në numrin rendor 2 nga subjekti politik LDK përshkak të ndërrimit të funksionit publik dhe në vend të saj CAKTOHET, Albiona Tasholli nga subjekti i njëjtë politik-LDK-ja

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale

Nr.03/L-040, neneve 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 15Nr.020-78081 të datës 24.12.2021 .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

VII

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini tha se për anëtarë të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ne si grup i LDK-së i propozojmë:

Nexhmedin Lekiqi,
Gazmend Qerkini,
Shefki Bytyqi,

Ndërsa për Komitet për Arsim, i propozojmë:

Xhyzide Rrustemi,
Sami Bytyqi,
Armend Grajqevci,

Ndërsa për Kulturë, Rini dhe Sport ne si grup i LDK-së i propozojmë

Rinor Murati,
Fadil Sopa,
Shkelzim Olluri,

Arsim Jashari, ne si grup i PDK-së i propozojmë:

Për anëtarë të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Ganimete Qeriqi

Për Komitet për Arsim, i propozojmë

Herolin Kozhanin

Ndërsa për Kulturë, Rini dhe Sport ne si grup i PDK-së i propozojmë

Ardit Canin

Shahadije Bikliqi, tha se për anëtarë të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ne si grup i LVV-së i propozojmë:

Fitim Mëziun

Ndërsa për Komitetin për Arsim

Shkelqim Kozhanin

Daut Azemi tha se nga subjekti politik AAK do të jetë Bashkim Budakova, në Komitetin për Kulture Rini dhe Sport

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se mirë që po themelohen këto Komitete, shpresoj që në të ardhmen kanë mu themeluar edhe komitete tjera, e propozoj që në të ardhmen që të formohet edhe Komiteti për Barazi Gjinore.

Daut Azemi, tha se momentin që i themelojmë komitetet tjera do ta kemi parasysh edhe propozimin tuaj.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30, aprovoi:

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Nexhmedin Lekiqi, anëtar subjekti politik LDK
2. Gazmend Qerkini, anëtar subjekti politik LDK
3. Shefki Bytyqi, anëtar subjekti politik LDK
4. Ganimete Qeriqi, anëtare subjekti politik PDK
5. Fitim Mëziu, anëtar subjekti politik LVV

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30, aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIAL

Neni 1

Themelimi

Me këtë Vendim, **Themelohet** Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Nexhmedin Lekiqi, anëtar subjekti politik LDK
2. Gazmend Qerkini, anëtar subjekti politik LDK
3. Shefki Bytyqi, anëtar subjekti politik LDK
4. Ganimete Qeriqi, anëtare subjekti politik PDK
5. Fitim Mëziu, anëtar subjekti politik LVV

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

1. Bën monitorimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në komunë ,
2. Bën monitorimin e zbatimit të dispozitave në lidhje me familjet me kushte të rënda sociale, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, fëmijët e mitur, të pastrehët , invalidët e luftës dhe pensionistët.
4. Konsultohet dhe ndihmon Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale.
5. Komiteti gjatë gjithë punës së tij do të përmahet dispozitatave të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë.
6. Kryen dhe punë të tjera nga fusha e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale.

Neni 4

Mandati

Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka mandat 4 vjeçar

Neni 5

Kompensimi

Anëtarët e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale kompensohen nga buxheti i komunës.

Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Anëtarët e komiteteve tjera paguhen për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

VIII

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Arsim.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi tha: Komiteti për Arsim i Komunës së Lipjanit, , në përbërje si vijon:

6. Xhyzide Rrustemi, anëtare nga subjekti politik LDK
7. Sami Bytyqi, anëtar nga subjekti politik LDK
8. Armend Grajqevci, anëtar nga subjekti politik LDK
9. Herolind Kozhani, anëtar nga subjekti politik PDK
10. Shkelqim Kozhani, anëtar nga subjekti politik LVV

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30, aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR ARSIM

Neni 1

Themelimi

Me këtë Vendim, **Themelohet** Komiteti për Arsim i Komunës së Lipjanit, , në përbërje si vijon:

1. Xhyzide Rrustemi, anëtare nga subjekti politik LDK
2. Sami Bytyqi, anëtar nga subjekti politik LDK
3. Armend Grajqevci, anëtar nga subjekti politik LDK
4. Herolind Kozhani, anëtar nga subjekti politik PDK
5. Shkelqim Kozhani, anëtar nga subjekti politik LVV

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Arsim bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtar i më i vjetër i komitetit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për Arsim kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

1. Bën monitorimin e punëve dhe aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e arsimit.
2. Konsultohet dhe ndihmon Drejtoratin për Arsim në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e arsimit.
3. Komiteti gjatë gjithë punës së tij do të përmbahet dispozitatave të Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve për përhershme dhe komiteteve tjera në komunë.
4. Kryen dhe punë të tjera nga fusha e arsimit

Neni 4

Mandati

Komiteti për arsim ka mandat 4 vjeçar

Neni 5

Kompensimi

Anëtarët e arsim kompensohen nga buxheti i komunës.

Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Anëtarët e komiteteve tjera paguhen për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

IX

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit, , në përbërje si vijon:

Rinor Murati, anëtar nga subjekti politik LDK
Fadil Sopa, anëtar nga subjekti politik LDK
Shkelzim Olluri, anëtar nga subjekti politik LDK
Ardit Cani, anëtar nga subjekti politik PDK
Bashkim Budakova, anëtar anëtar nga subjekti politik AAK

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për aprovoi vendimin

Shtesë: Vendimi

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 1

Themelimi

Me këtë Vendim, **Themelohet** Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit, , në përbërje si vijon:

1. Rinor Murati, anëtar nga subjekti politik LDK
2. Fadil Sopa, anëtar nga subjekti politik LDK
3. Shkelzim Olluri, anëtar nga subjekti politik LDK
4. Ardit Cani, anëtar nga subjekti politik PDK
5. Bashkim Budakova, anëtar anëtar nga subjekti politik AAK

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për kulturë rini dhe sport kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

1. Bën monitorimin e aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit.
2. Konsultohet dhe ndihmon Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit.
3. Kryen dhe punë të tjera nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 4

Mandati

Komiteti për kulturë, rini dhe sport ka mandat 4 vjeçar

Neni 5

Kompensimi

Anëtarët e komitetit për kulturë, rini dhe sport, kompensohen nga buxheti i komunës.

Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Anëtarët e komiteteve tjera paguhen për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Daut Azemi, tha se po kthehemi edhe një herë **te Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.**

Pastaj tha se i ftoj shefat e grupeve te kuvendnit ne zyrën time te diskutojmë dhe një herë te gjithë se bashku, dhe kërkoj një pauze prej 5 minutave.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se pari i falënderoj te gjithë shefat e grupeve për bashkëpunimin e treguar, unë të kërkoj falje Lulzim Rustemi, se nuk ke diçka personale kjo por kështu na thotë udhëzimi dhe ne duhet ta zbatojmë

Pasi u kthyen nga pauza Kryesuesi e hapi diskutimin.

Arsim Jashari, une e faldneroj Lulzim Rrustemin për gatishmërinë, qe te lëshoj rrugë në mënyrë qe te respektohet barazia gjinore, dhe ne si grup e propozojmë Lumturioje Bytyqi-Hasani për anëtare të këtij komiteti

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për aprovoi vendimin

Shtesë: Vendimi

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete ka mandat 4 vjeçar

Neni 3

Kryesuesi i Komitetit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Komunitete emërohen si vijon:

1. Gentianë Hoxhaj, anëtare e Kuvendit LDK
2. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare e Kuvendit PDK
3. Shahadije Bikilqi-Dragaçina, anëtare e Kuvendit LVV
4. Enver Kryeziu, anëtar i Kuvendit PAI – komuniteti ashkali
5. Idajet Garip, komuniteti rom
6. Slavisa Trajkovic, komuniteti serb
7. Skender Bikliqi, komuniteti turk
8. Zoran Cirkovic, komuniteti malazez

9. Ana Guciq, komuniteti kroat

Neni 5

Komiteti për komunitete në pajtim me dispozitat e nenit 53 par.53.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,³⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi